



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 428 Prot.

Durrës më, 11 / 3 / 2022

V E N D I M

Nr. 11 Datë 11 / 3 2022

"PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE BACHELOR SI DHE NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL (2 VJEÇAR), NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE MASTER I SHKENCAVE DHE PROFESIONAL SI DHE NË CIKLIN E TRETË TË STUDIMEVE "DOKTORATË", PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023 PRANË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe referuar shkresës nr.98/5 datë 08.02.2022 të Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, shkresës nr.98/1 datë 25.01.2022 të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, shkresës nr.98/2 datë 27.01.2022 të Fakultetit të Studimeve Profesionale, shkresës nr.98/3 datë 04.02.2022 të Fakultetit të Edukimit, shkresës nr.98/4 datë 04.02.2022 të Fakultetit të Biznesit, lidhur me përcaktimin e kuotave për të tre ciklet e studimit, për vitin akademik 2022 – 2023, shkresës së MAS nr.1392 prot, datë 02.03.2022, vendimit të Senatit Akademik nr.13, datë 07.03.2022, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kuotave të pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve Bachelor si dhe në programet e studimeve me karakter profesional (2 vjeçar), në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave dhe Profesional si dhe në ciklin e tretë të studimeve "Doktoratë", për vitin akademik 2022-2023, pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Drejtoria e Kurrikulave dhe Standarteve të Cilësisë
 - Drejtoria e Administrimit Financiar
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

